

Njoftim për zëvendësimin e deklaratës noteriale me deklaratë të thjeshtë për regjistrim vepre

Drejtoria për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me to (DDA) njofton të gjithë krijuesit/autorët të çdo krijimi intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, të cilët dëshirojnë të aplikojnë **në procedurën e regjistrimit vullnetar** për veprën e tyre pranë Ministrisë së Kulturës, se me hyrjen në fuqi të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.34, datë 18.01.2017 "Për procedurat e regjistrimit, të organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave të autorit" depozitimi i deklaratës noteriale është zëvendësuar me aktin “Deklaratë” e cila plotësohet përpara nëpunësit të DDA-së.

Lutem mbani parasysh ndyshimin e mësipërm të këtij dokumenti në mënyrë që çdo aplikues të mos të ngarkohet me shpenzime shtesë në këtë procedurë regjistrimi e drejtë autori.

Për çdo informacion tjetër shtesë, lutemi t’i drejtoheni kësaj drejtorie ose nëpërmjet emailit dda@kultura.gov.al